



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



Buletini IV

25 Shkurt 2015

INPO ka vazhduar monitorimin e Gjykatës Themelore në Ferizaj, degët në Kaçanik dhe në Shtërpçë, në kuadër të projektit “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”. Gjatë periudhës, 15 Janar - 15 Shkurt janë monitoruar gjithsej katërbëdhjetë (14) seanca, prej tyre gjashtë (6) seanca të lëmisë penale, tetë (8) për çështje civile. Gjatë kësaj periudhe të monitorimit, është vërejtur një numër në rritje i qytetarëve të interesuar për të marrë pjesë në shqyrtimet gjyqësore.

Të dhëna statistikore:

Pjesëmarrja e qytetarëve në seanca sipas çështjes:

Çështja e Gjykuar	Numri i pjesëmarrësve
Vepër Penale	60
Kontest Civil	20

Përkundër pjesëmarrjes së dobët të qytetarëve në seancat gjyqësore, pjesëmarrës në seanca ishin studentët të cilët INPO i stimulon në vazhdimësi, me qëllim të shohin për së afërmi dhe të informohen për hapat të cilat mirren për shqyrtim të një lënde.

Puntoria për studentët e fakultetit juridik

Në fund të muajit janar është mbajtur puntoria njëditore me studentët e fakultetit juridik të cilët kanë vendbanim në Komunën e Ferizajt, të cilët njëherit janë edhe vullnetar të projektit në monitorimin e gjykatës. Temat e ligjeruara ishin: Njohuri për sistemin e ri të drejtësisë, Parimi i Publicitetit dhe rëndësia e tij në procedurë gjyqësore, etj. Përmes temave të ligjeruara në këtë puntori, nga Kushtrim Palushi, LLM, jemi munduar të mbulojmë një fushë të njohurive të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës. Përpos aspektit teorik, studentët kanë pasur mundësi të realizojnë

edhe një simulim të një gjykimi, në një rast hipotetik të ofruar nga ligjeruesi i puntorisë.

TAKIMI PUBLIK me temën "Ngritja e besimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin e drejtësisë përmes informimit"

Në fillim të muajit Shkurt, është mbajtur takim publik me institucionet e drejtësisë dhe qytetarë, për të diskutuar rreth ngritjes së besimit dhe pjesëmarrjes të qytetarëve në sistemin e drejtësisë.

Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e informimit të qytetarëve nga institucionet e drejtësisë, me qëllim të ngritjes së besimit në këto institucione. Panelistët kontribuan në informimin lidhur me punën e institucioneve të drejtësisë në lehtësimin e qasjes në informacion.

Ndër problemet kryesore që u shtruan nga pjesëmarrësit e tjerë ishin: mosfunktionalizimi në kohë i Zyrës për Informim pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj, mungesa e një zyrtari për informim pranë Prokurorisë Themelore në Ferizaj, e cila shkakton kufizim në qasjen ndaj informatave. Gjykata Themelore në Ferizaj përballet me mungesën e gjykatësve dhe si rrjedhojë e kësaj ekziston një numër i madh i lëndeve të pavendosura. Gjithashtu, mungesa e një faqeje elektronike për Gjykatën Themelore dhe Prokurorinë ishin njëra ndër shqetësimet që u ngritën nga qytetarët.

Disa nga rekomandimet e nxjerra nga ky takim ishin funksionalizimi i Zyrës për Informim; mundësia për themelimin e një zyreje të informimit për Prokurorinë; rritja e informimit për institucionet, si Noteria dhe Ndërmjetësuesit; krijimi i faqeve elektronike në Gjykatën Themelore dhe Prokurorinë.

Iniciativa për Progres, Projekti “Ngritja e vetëdijës dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në sistemin gjyqësor”

“Ky buletin u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombtar (USAID). Përmblajtja është përgjegjësi e INPO-s dhe nuk pasqyron deomos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara”